

VENDIM
Nr.339, datë 1.4.2009

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.305, DATË 12.3.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË ATASHEVE
USHTARAKË, TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, QË
SHËRBEJNË NË SHTABET E NATO-S E NË PËRFAQËSITË USHTARAKE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË NATO-S, DHE TË USHTARAKËVE
SHQIPTARË, QË SHËRBEJNË PRANË ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE DHE
NË SHTABET NDËRKOMBËTARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.305, datë 12.3.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

1. Në fund të shkronjës “gj” të pikës 1 të shtohen fjalët “... zyrë dhe kancelari.”
2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1 Atashetë ushtarakë dhe përfaqësitë ushtarake kanë të drejtë të prokurojnë, brenda fondeve buxhetore, të vëna në dispozicion për kryerjen e shpenzimeve, të përmendura në shkronjat “e”, “gj”, “h” e “i” të pikës 1 të këtij vendimi, dhe janë të detyruara të zbatojnë rregullat e prokurimit publik, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Kur përfaqësia nuk disponon numrin e nevojshëm të personelit, për kryerjen e procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit për prokurimin publik, dërgon ofertat në Ministrinë e Mbrojtjes, e cila bën përzgjedhjen dhe miraton ofertën më të përshtatshme.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha